



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 628, datë 10.12.2020

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. IRIDA KACERJA
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË
DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 394, DATË 07.10.2020, TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË
VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 10.12.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, të kandidates znj. Irida Kacerja”, përgatitur nga relatori z. Ilir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj. Irida Kacerja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”.

2. Në këtë vendim afati i kandidimit është përcaktuar “*deri më datë 23.10.2020*”.

3. Ky vendim i Këshillit, sikundër edhe njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë, janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 07.10.2020.

4. Brenda afatit të kandidimit për këtë pozicion të lirë, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. Irida Kacerja (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

5. Më herët, me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka hapur procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile. Për këto dy pozicione të lira ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. Irida Kacerja.

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, Këshilli ka vendosur fillimin e procedurave të verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët që kanë kandiduar, ndër të tjerë, edhe për dy pozicionet e lira sipas pikës 5 të këtij vendimi, përfshirë edhe për kandidaten znj. Irida Kacerja. Në këtë rast, për realizimin e procedurës së verifikimit të kandidates në fjalë, me short, si relator, është caktuar anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z.Illir Toska. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019), si dhe pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 181 dhe nr. 183, datë 26.02.2020, relatori kreu procedurën e verifikimit paraprak të kandidates në lidhje me tre kriteret formale¹ të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira të shpallura me këto vendime, që të dyja në fushën e të drejtës civile. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak, me Vendimin nr. 279, datë 08.09.2020, Këshilli vendosi:

“1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidatja znj.Irida Kacerja, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020. ...”.

7. Aktualisht kandidatja është në procedurë vlerësimi profesional dhe etik, e cila po realizohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, procedurë e cila po zhvillohet paralelisht me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kësaj kandidate nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në kuadër të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

8. Ndërkohë, mbas përfundimit të afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile sipas pikës 1 të këtij vendimi, Këshilli, me Vendimin nr. 541, datë 05.11.2020, vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura, ndër të tjerë,

¹ Tre kriteret formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit janë: “përvoja profesionale minimale”, “mospasja masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

edhe me vendimin në fjalë². Në këtë rast, sipas këtij vendimi³, procedurat e verifikimit për kandidatët të cilët kishin kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, do të vijonin të kryheshin nga të njëjtët relatorë, bazuar kjo në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit 75/2019, ku përcaktohet se: *“Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”*. Referuar këtij përcaktimi, në pikën 3 të vendimit, Këshilli vendosi që për kandidaten znj. Irida Kacerja, e cila ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, konkretisht në Gjykatën e Apelit Tiranë, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që është në proces e sipër për këto kandidime (*nënkupto këtu Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020*), është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020.

9. Më datë 05.11.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020.

10. Në pikën 9, të Vendimit të Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020, sikurse në të njëjtën pikë edhe të Vendimeve të tij nr.181 dhe nr.183, datë 28.05.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatën, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kritereve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, bazuar në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, në Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020 (pika 5, shkronja “a”) përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen ..., si mëposhtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar...”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

11. Sa i përket verifikimit të plotësimin nga kandidatja znj. Irida Kacerja të tre kritereve formale të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020, pra të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, në kushtet kur kandidatja është verifikuar për plotësimin e këyre kritereve në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë

² Vendimin nr.394, datë 07.10.2020.

³ Vendimi nr. 541, datë 05.11.2020.

për dy pozicionet e tjera të lira në të njëjtën fushë të së drejtës, pra atë civile⁴, u çmua se nuk kishte vend për kërkimin dhe administrimin përsëri të të njëjtit dokumentacion zyrtar, duke qenë i vlefshëm për qëllimet e këtij verifikimi dokumentacioni i administruar më parë, duke e shtrirë në këtë rast kërkimin në lidhje me kriterin e “përvojës specifike profesionale”, vetëm për periudhën pas datës 19.06.2020. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër informacioni është dërguar me Shkresën nr. 930 prot., datë 13.11.2020, siç do të përshkruhet më poshtë. Edhe për kriteret e “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale” u kryen disa veprime verifikuese, sikurse do të përshkruhen më poshtë, në funksion të verifikimit të ekzistencës së ndonjë të dhëne të ndryshme nga sa më parë, kjo për shkak se këto rrethana janë potencialisht të ndryshueshme qoftë edhe në një kohë të shkurtër.

12. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit paraparak në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit për kandidaten Irida Kacerja për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 394, datë 07.10.2020, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 20.11.2020, relatori e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

13. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 20.11.2020 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në Seksionin C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për verifikimin e plotësimit ose jo nga kandidatja znj. Irida Kacerja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

14. Për kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

15. Plotësimi nga kandidatja i kriterit të “përvojës profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, është verifikuar me parë nga Këshilli në kuadër të kandidimeve të mëparshme të saj për dy pozicione të lira në këtë fushë të së drejtës, referuar për këtë Vendimit të tij nr. 279, datë 08.09.2020, në të cilin është arritur në përfundimet se:

“19. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. Irida Kacerja, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si

⁴ Për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020.

gjqtare e gjykatës së shkallës së parë, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale”.

...

23. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. Irida Kacerja, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, ka mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

16. Përveç sa sipër, sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se: “Gjyqtari Irida Kacerja prej datës 19.06.2020 e në vijim ushtron funksionet e gjyqtarit, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në seksionin civil sipas urdhërit të brendshëm nr. 24, datë 28.01.2019”.

17. Kandidatja znj. Irida Kacerja, sikurse më herët, por edhe nga sa rezulton në vijim, ka kandiduar për të njëjtën fushë të së drejtës, atë civile dhe për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me këtë vendim, ajo ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë, nga të cilat mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës profesionale minimale” dhe kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

18. Për kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

19. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 394, datë 07.10.2020, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 22.10.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.

20. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, ka rezultuar se kandidatja znj. Irida Kacerja nuk kishte masa disiplinore në fuqi, ndërsa në pikën 28, të Vendimit nr. 279, datë 08.09.2020, Këshilli ka arritur në përfundimin se: “Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. Irida Kacerja të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

21. Ndërkohë, pra mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 279, datë 08.09.2020, nuk rezulton që ndaj kandidates të jetë marrë ndonjë masë disiplinore⁵. Për rrjedhojë, Këshilli vlerëson se nuk

⁵ Referuar nenit 105 të Ligjit për Statusin vendosja e masës disiplinore ndaj gjyqtarit është kompetencë e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

vërtetohet që kandidatja znj. Irida Kacerja të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

22. Për kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

23. Në rastin e kandidimit për pozicionin e shpallur me Vendimin nr. 245, datë 09.07.2020, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 22.10.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

24. Në rastin e procedurës së verifikimit në kuadër të kandidimit për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020, në pikën 33 të Vendimit të tij nr. 279, datë 08.09.2020, Këshilli ka arritur në përfundimin se: *“Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. Irida Kacerja nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.”.*

25. Ndërkohë, mbas marrjes së Vendimit të Këshillit nr. 279, datë 08.09.2020, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet ekzistenca e ndonjë rrethanë të ndryshme nga sa është konstatuar më parë në lidhje me qenien e kandidates znj. Irida Kacerja në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

26. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 394, datë 07.10.2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. Irida Kacerja, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

27. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. Irida Kacerja, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. Irida Kacerja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 394, datë 07.10.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj.Irida Kacerja, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 394, datë 07.10.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj.Irida Kacerja sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR